



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr _____prot

Tiranë më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 359 datë 11.07.2024

**PËR
KUALIFIKIMIN E KANDIDATES FITUESE PËR NË PROGRAMIN E
FORMIMIT FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, VITI
AKADEMIK 2023 – 2024, PROFILI NDIHMËS LIGJOR, ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 53, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; në nenin 61, pika 1, 86 shkronja “ë” dhe 97 pika 1, shkronja “a” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja e procedurës së verifikimit znj. Gentiana Muçaj, mbi gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatës fituese për në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor, znj. {...},

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidatës fituese znj. {...} dhe lejimin e saj për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor.
2. Një kopje e vendimit të arsyetuar t’i njoftohet kandidatës, znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR